



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3363/3 Prot.

Gramsh, më 29.08. 2025

V E N D I M

Nr. 71 Datë 29/08/2025

**Për miratimin e themelimit të shoqërisë sportive "KLUBI I FUTBOLLIT TË FEMRAVE
"KFF GRAMSHI" sh.a.**

Këshilli Bashkiak Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 29.08.2025, duke marrë në konsideratë nevojat për zhvillimin e sportit të futbollit në Bashkinë e Gramshit, pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (të ndryshuar), në ligjin nr. 9723, datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit" (të ndryshuar), në ligjin nr. 79/2017 "Për sportin" (i ndryshuar) si dhe në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";

VENDOSI:

1. Të miratojë themelimin e shoqërisë sportive "KLUBI I FUTBOLLIT TË FEMRAVE "KFF GRAMSHI" sh.a, në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë private.
2. Të miratojë aktin e themelimit dhe statutin e kësaj shoqërie, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Aksionari i vetëm i shoqërisë dhe zotërues i 100% të aksioneve është Bashkia Gramsh.
4. Kapitali themelues i shoqërisë është 3,500,000 lekë.
5. Transferimin e fondit prej 3,500,000 lekë, në buxhetin e vitit 2025, nga artikulli 602(shpenzime operative) program 8130 në artikullin 604 programi 8130 për financimin e pikës 4 të këtij vendimi.
6. Autorizohet Kryetari i Bashkisë, ose personi i autorizuar prej tij, për aplikimin e regjistrimit fillestar të shoqërisë, sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 9723, datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit (i ndryshuar).

7. Autorizohet Kryetari e Bashkisë Gramsh, z. Besion Ajazi, të përfaqësojë Bashkinë Gramsh si aksionar të shoqërisë "KLUBI I FUTBOLLIT TË FEMRAVE "KFF GRAMSHI" sh.a., në të gjitha mbledhjet që do të zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "KLUBI I FUTBOLLIT TË FEMRAVE "KFF GRAMSHI" sh.a, gjatë gjithë periudhës së mandatit të Këshillit të Bashkisë Gramsh.
8. Pas regjistrimit si shoqëri tregtare, të fillojnë procedurat e regjistrimit të kësaj shoqërie si anëtare në Federatën Shqiptare të Futbollit, sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 79/2017 "Për sportin" (i ndryshuar).
9. Për të zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Kryetari i bashkisë dhe administrata e bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT
Enis ZANI

